



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

Të mbledhjes së katërt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb), i mbajtur më 06.10.2022.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës së Prishtinës.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit komunalë, përfaqësuesit e këshillave të bashkësive, përfaqësuesit e komuniteteve, përfaqësuesit e grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës etj.

Në vazhdim Zogaj falënderoi Organizatën ndërkombëtare IOM, që sipas raportit të takimit do ta kemi edhe një punëtorë pas mbledhjes së katërt të KKSb-së.

Kryesuesi theksoi se është privilegj që merr pjesë në këtë takim. Ai pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar diçka rreth rendit të ditës.

Njëzëri u miratua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të KKSb-së;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Trafikimi i qenieve njerëzore, drogës, fajdeve, ekstremizmit dhe dhunës në familje;
4. Fillimi i vitit shkollor 2022-2023;

Punëtorja e përkrahur nga IOM:

1. Diskutimi mbi qasjen për zgjidhjen e problemeve të sigurisë, të identifikuara në punëtorinë e kaluar;
2. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë.

Njëzëri u miratua ekstrakti i mbledhjes së tretë.

**Pika e dytë**

Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës.

Fjalën e marrin komandantët e stacioneve policore në komunën e Prishtinës.

**Niman Januzaj, komandant i Stacionit policor "Qendra"** theksoi se në Stacionin policor "Qendra" situata është në nivelin e duhur, është e qetë.

Si stacion që veprojë në angazhimet tona ditore dhe në këtë përmblyllje të nëntëmujorit, ka pasur

rezultate të kënaqshme.

Një krahasim me rastet që janë raportuar në vitin paraprak, kemi një rënie të lehtë me raportimet e rasteve në polici, që lë të kuptohet se falë angazhimeve policore, në bashkëpunim me komunitetet, ka rënie në rastet kryesore, kemi rënie të lëndimeve trupore, rastet e vjedhjeve, rastet e grabitjeve dhe dhunës në familje.

Tek aksidentet në komunikacion ka një rënie të lehtë, aksidentet me lëndime dhe dëme materiale i takojnë nivelit rajonal, sepse është njësi më e specializuar.

Te gjërat në trafik kemi ngritje të konsiderueshme, çështja e veprave që kanë të bëjnë me narkotik, që është një shqetësim madhor, kemi zbulueshmëri, pavarësisht që si stacion merremi me raste më të lehta, ato më të rënda i takojnë nivelit qendror.

Edhe për nëntëmujorin kemi rezultate të konsiderueshme, kemi angazhime ditore në ngjarje publike, vizita ndërkombëtare, evenimente të ndryshme, por jo vetëm në këtë drejtim, por edhe në kërkesat, ankesat e problematikat që paraqiten, përpiqemi t'i zgjidhim dhe t'i drejtojmë në institucionet përkatëse.

Sa i përket sigurisë në shkollë, jeni të njoftuar se ka filluar zbatimin e planit operativ, që më pas sa me të lehtë komunikimin me drejtorët të institucioneve përkatëse edhe me organe komunale, nëse ka problematika me të bërë zgjidhje aty për aty.

**Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni policor "Veriu",** tha se gjendja e sigurisë në Stacionin "Veriu" është e mirë, për këtë i falënderojmë komunitetet që bashkëpunojnë afër me ne dhe të gjithë aktorët që kemi bashkëpunim. Sa i përket numrit të veprave penale të regjistruara në Stacionin policor "Veriu", jemi me një numër të njëjtë krahasuar me vitin e kaluar. Kemi zbritje me veprat penale kundër jetës dhe trupit, gjithashtu veprat penale kundër dhunës në familje, zbritje kundër pasurisë, me përjashtim të veprave penale vjedhje, që në këtë rast dua ta ngrit si shqetësuese rritjen e numrit të vjedhjeve në rrjetin e marketeve "Viva", që si stacion iu kemi bërë kërkesë menaxherëve me të diskutuar çështjen e vjedhjeve në këto markete, që nuk ndodh nëpër marketet tjera. Dyshimet tona janë që stafi nuk është vigjilent gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Kemi rritje të numrit të rasteve të veprave penale për armëbajtës pa leje me 63.63%, kemi rritje të veprave penale kundër narkotikëve me 92 %, këtu mund ta shohim një angazhim shtesë të policëve në terren, të cilët kanë me të identifikuar kryerësit e këtyre veprave.

Kemi ulje të numrit të aksidenteve në trafik, ku në këtë rast e falënderojmë Drejtorinë përkatëse të Komunes së Prishtinës, të cilët e kanë bërë shenjëzimin e rrugëve aty ku është kërkuar. Tek zbulueshmëria kemi rritje të numrit.

Sa i përket sigurisë në shkollë jemi në zbatim të planit operativ, deri më tani nuk kemi ndonjë rast që duhet cekur për sigurinë në shkollë.

**Bekim Zogjani, kapiten, zv. komandant i Stacioni policor "Jugu", në Prishtinë,** tha se situata e sigurisë në zonën tonë është e qetë dhe stabile, nuk kemi ndonjë informatë që ka ndonjë indikacion për prishje të qetësisë në përmasa të mëdha.

Sa i përket rasteve për këtë nëntëmujor, në bazë të analizave edhe raportimeve të rasteve, kemi një ulje në 7.3% krahasuar me vitin e kaluar. E gjithë kjo është arritur falë bashkëpunimit që kemi me akterët tanë në ofrimin e sigurisë.

Sa i përket veprave penale kundër pasurisë, që është shqetësim, kemi një rënie të këtyre veprave më -2% në krahasim me vitin e kaluar, më të theksuara që kanë qenë vjedhjet e rënda, në këtë nëntëmujor kemi një rënie prej 6.4 %, lëndime të lehta trupore kemi rënie prej 28%, rastet e grabitjeve që hynë këto të gjitha në kuadër të veprave kundër pasurisë, kemi një rënie për 42.9%.

Shqetësuese janë rastet e dhunës në familje, prej të cilave kemi një ngritje prej 25% më shumë se në

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sa i përket çështjeve të armëmbajtësve pa leje, kemi një ngritje të konfiskimit të armëve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar rreth 95%.

Çështja e narkotikëve në zonën e përgjegjesisë në këtë nëntëmujor ka shënuar një rënie prej 23%, për shkak të angazhimeve të shumta, tek aksidentet në komunikacion ka një rënie prej 14.4%, që është një sukses i stacioneve policore.

Stacioni policor "Jugu" ka aktive planet për parandalimin e veprave penale, planet për prishjen e rendit dhe qetësisë publike. Po ashtu, jemi duke punuar në bashkëpunim me Inspeksionin që atyre qytetarëve t'iu ofrohet një jetë e qetë.

Me fillimin e vitit të ri shkollor, stacioni ynë ka të angazhuar zyrtarë me rroba civile, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me menaxherët e shkollave dhe Drejtorinë e Arsimit. Situata në përgjithësi është e qetë.

**Alban Zogaj** theksoi se ne i kemi dy kërkesa për Policinë e Kosovës:

Kërkesa e parë, ka të bëjë me parkimin e veturave në trotuare, të cilat e cenojnë sigurinë e qytetarëve. E dyta, ka të bëjë me ankesat e qytetarëve për prishjen e qetësisë publike në dy lokacione kryesore në Prishtinë, e para është qendra e Prishtinës, pjesa e sheshit, dhe e dyta është rruga "B".

Ne kemi marrë masa shtesë, do t'i vendosim mjete që në kohë reale do ta matin lartësinë e zërit se cilët po e prishin qetësinë dhe do të kemi nevojë për ndihmën tuaj, që bashkërisht ta zgjidhim këtë problem. Po ashtu, edhe problemet që i kanë nxënësit për prishjen e rendit rreth shkollave.

**Niman Januzaj** theksoi se qendra është e mbingarkuar me automjete, por përkundër këtyre kundërvajtësve gjatë muajit shtator i kemi shqiptuar 1300 gjoba vetëm një stacion policor. Duhet me menduar pak a shume me u bërë sa më shpejt parkingjet, ku do të mund t'i parkonin makinat qytetarët. Ne po e kryejmë punën tonë vazhdimisht, pavarësisht a kanë parkingje a jo.

Tek rendi dhe qetësia publike, përjashtimisht ne i kemi evidencat për çdo thirrje, ku njësia reagon dhe ndërmerren veprime.

Tek zhurma, është pak specifike matja e zhurmës, por ku e parasheh ligji, në rrethana ne orar të caktuar ne marrim masa pa inspektor.

**Alban Zogaj** u shpreh i pajtimit me mendimin e majorit Jonuzaj, se kryeqyteti është i mbingarkuar me vetura. Në bazë të një studimi që e kemi bërë me Bankën Botërore, 130.000 vetura hyjnë prej jashtë Prishtinës, për secilën prej tyre kërkohet një cep për t'u parkuar, kudo që t'i jepet mundësia. Ne si Komunë e Prishtinës, po punojmë për ndërtimin e parkingjeve në hyrje të Prishtinës, në periferi, në mënyrë që këto vetura të kenë mundësinë e parkimit në atë pjesë, pastaj qytetarët t'i shfrytëzojnë format tjera të transportit brenda qytetit.

**Melihate Sefedini** theksoi se ne si stacion "Veriu" përballemi me dy çështje tjera, shitësit ambulante që ne si polici jemi të kufizuar me autorizime rreth largimit të shitësve ambulante. Taksitë ilegale janë shumë, sidomos në rr. "Ilir Konushevi", edhe aty jemi të kufizuar, nuk mundemi me vepruar kur ata operojnë në transport të udhëtarëve. Ne jemi të gatshëm, çdoherë do ta keni përkrahjen tone do t'iu asistojmë ne largimin e tyre.

**Bekim Zogiani** theksoi se në kuadër të stacionit që ne i përkasim, gjatë këtij 9-mujori janë shqiptuar 10340 gjoba për kundërvajtje të ndryshme në komunikacion. Një çështje që po del si pengese është edhe konfiskimi i veturave, me gjobat që lihen në vetura nuk po zgjidhim asgjë e qytetarin prap e pengon. Ju kisha lutur që të bëni një zgjidhje për merimangat që i konfiskojnë veturat.

Prishja e rendit dhe qetësisë është shqetësuese, për çdo natë i kemi ekipet në rrugët "B" dhe "C", ka gjoba por prap përsëritën, duhet të behet një zgjidhje tjetër që këto të mos përsëriten.

## **Pika e tretë**

**Trafikimi i qenieve njerëzore, drogës, fajdeve, ekstremizmit dhe dhunës në familje.**

**Niman Januzi** lidhur me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore, stacioni ynë nuk qëndron keq, në bazë të statistikave që i kemi, për të folur më kompetent dhe për të dhënë informacione të sakta mundem me ju referuar. Vëmendjen e kanë policia në këtë drejtim, ne jemi njësi reaguese fillestare, dalim në vendin e ngjarjes dhe i adresojmë.

Sa i përket drogave, kemi numër të caktuar, kemi identifikuar një numër të rinjsh që janë duke u marrë me këto, i kemi adresuar, kemi hapur raste dhe i kemi dërguar në prokurori.

Tek fajdet, është njësi e veçantë, janë stacionet që merren me këtë punë, problematikat e këtyre rasteve duhet me i trajtuar me nivelin qendror, me çështjen e ekstremizmit jemi mirë.

Tek dhuna në familje raportimet janë të ngjashme me muajin paraparak të vitit të kaluar, por është e rëndësishme që janë adresuar me kohë të gjitha raportimet në këtë drejtim, jemi munduar me çdo kusht me pas kontakte të vazhdueshme që mos me u përsëritur si ngjarje. Në aspektin e organizimit si polici, problematikat kryesore që janë përcaktuar në piken tre, i trajtomë me një seriozitet më të madh si rastet më të ndjeshme në shoqëri.

**Lulzim Vrapca**, përfaqësues i Drejtorisë së Arsimit, tha se në shkollat që i përkasin drejtorisë sonë kanë qene dy raste të trafikimit të qenieve njerëzore, të miturave, konfidenciale që janë trajtuar dhe janë procesuar më tutje.

Përdorimi i drogës nga të rinjtë në institucionet edukativo arsimore rrjedhimisht janë realizuar projekte vetëdijesuese, duke i thirrur nxënësit, iu kemi dhënë broshura. Ne kemi një bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale dhe me Policinë e Kosovës. Ajo çka ne jemi duke synuar jo vetëm nga policia e Kosovës, por edhe organizatat të cilat janë të specializuara, të licencuara në Ministrinë e Arsimit, që të kenë të drejtë të ligjërojnë në këtë fushë.

Gjatë kësaj kohe arsimit ka qenë në vëmendje dhe shumë aktivitete që kanë qenë të parapara janë pezulluar ose janë shtyrë për muajin e ardhshëm.

Sa i përket të drejtave të njeriut, mbajtjes së shamisë, ne si Komunë e Prishtinës kemi qenë koherent që mos të cenohen të drejtat e njeriut në aspektin e përgjithshëm, pavarësisht udhëzimeve administrative në fuqi.

**Armend Ahmeti**, KLSP Bardhosh, një grup prej përfaqësuesve të KLSP-ve të Prishtinës, kemi kryer një trajnim prej misionit të OSBE-së për siguri publike, kështu që kishim mundur me dhënë kontributin tonë për këto elemente, sepse jemi certifikuar me qenë trajnerë të fushave të caktuara, kishim mundur me plotësuar aty ku ka nevojë me mbajtur sesione vetdijesuese, ose trajnime me periudha afatgjata.

**Alban Zogaj** bëri të ditur se tashmë ka filluar sezoni i gjuetisë në rajonin e Prishtinës, në përgjithësi akoma nuk ka leje prej Komunës së Prishtinës për shoqatat e gjuetisë me i nda zonat dhe me dalë në gjueti legale. Kemi pasur një rast tragjik kohëve të fundit, por duhet parë se si me gjetur një bashkëpunim që me i parandaluar këto situata.

**Bekim Zogiani** theksoi se sezoni i gjuetisë për vitin 2022-2023 është lejuar, ka filluar nga 1 tetori në gjithë Republikën e Kosovës. Sa i përket Komunës në zonat e gjuetisë të cilat i ndajnë shoqatat, kjo është në nivel të Drejtorisë së Bujqësisë, shoqatat e gjuetarëve me i përcaktuar se cila shoqatë do të veprojnë në cilën zone, përkrahjen tonë do ta kenë si përherë.

## **Pika e katërt**

## Fillimi i vitit shkollor 2022-2023.

**Lulzim Vrapca** bëri të ditur se DKA-ja ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022-2023. Janë bërë investime në fushën e gëlqerosjes, energjetikës dhe të të gjitha problemeve të brendshme dhe të jashtme.

Sa i përket pjesës tjetër është çështje e anës politike, që përkundër mospagesës së mësimdhënësve, kemi pasur takime me drejtorët që të fillojë procesi mësimor dhe kane qene dakord. Ka reagime nga stafi mbështetës që pagesat të procedohen tutje, por adresa për këtë është Ministria e Arsimit.

Sa u përket nxënësve, realisht me fillimin e vitit të ri shkollor të gjitha institucionet edukative arsimore i kanë bërë raportimet e tyre mujore në Drejtorinë e Arsimit. Jemi në procesin e të dhënave, sa i përket anës së trajnimeve, i kemi buxhetuar trajnimet për mësimdhënësit dhe nxënësit, që të kemi një bashkëpunim më të mirë nxënës-prindër-mësimdhënës. Ky trekëndësh ka funksionuar shumë mirë, sepse organet komunale sa i përket anës së projekteve, si në fushën e trajnimeve, ashtu edhe në fushën e investimeve kemi qenë shumë koherent.

Jemi në përgatitje të dy shkollave të reja, janë rinovuar tërësisht, është shkolla "Iliria" dhe "Pjetër Bogdani", punët kanë shkuar siç është më së miri.

**Altin Gashi, KLSP Hajvali**, tha se një nga prioritetet ka qenë edhe rrethojat e shkollave, një prej dy shkollave të Hajvalisë e ka këtë mungesë, andaj kur do të fillojnë procedurat për këtë çështje, po ashtu ka mungesë të higjienës. Kemi pasur probleme, ka pas edhe therje, andaj duhet që sa më shpejt të merren masa që në përfundim të mësimin të mbyllen shkollat.

**Lulzim Vrapca** bëri të ditur se në momentin që lidhet kontrata me operator ekonomik kjo çështje do të zgjidhet. Kemi pasur takime me drejtorët e shkollave, janë në proces të vazhdueshëm për furnizimin e mjeteve higjienike me aparate të pastrimit që i kemi në vazhdimësi, është një linjë buxhetore nga Ministria e Arsimit dhe i kemi shpërndarë aty ku është nevoja me e madhe.

**Hilmi Halili, KLSP Kalabri**, tha se në shkollën "7 Marsi", e cila është ndërtuar në vitin 2003, janë bërë disa investime, kamerat i kemi vendosur në si KLSP, ndriçimin po, ka mbetur edhe një premtim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, kanë qenë në terren dhe e kane parë, është një ngushticë e rrugës ku kalojnë edhe kamionët dhe është rrezik për nxënësit. A ka ndonjë program më të shpejtë për ndonjë trotuar, sepse ajo pjesë është tokë komunale.

**Armend Ahmeti, KLSP Bardhosh**, me qenë se buxheti ka kaluar, ju përgëzoj si KLSP - Bardhosh, e kemi bërë një kërkesë, me qëllim që të lehtësohet mësimi sa më shumë, pra kërkesa është për ndërtimin e një shkolle të re në fshatin Bardhosh i Poshtëm.

**Lulzim Vrapca** bëri të ditur se shkollat që kanë më shumë nxënës janë prioritetet, si disa shkolla në kryeqytet, sa i përket shkollës njëherë përnjëherë është në planin afatshkurtër planin 5-vjeçar.

Në projektin e një mundësie buxhetore, p.sh. rruga "C", ka nevojë për shkollë fillore, të mesme dhe çerdhe. Nuk dua të ju premtoj që në afat katërvjeçar do të zotohet, sepse i kemi procedurat burokratike dhe e dini sa zgjasin.

**Izedin Bayram** tha se nëse doni me dënuar një popull, lëreni pa shkollë!

**Alban Zogaj** theksoi se Komuna e Prishtinës nuk ka qenë pjesë e këtij diskutimi, në mes të Sindikatës dhe Qeverisë, sepse greva është drejtuar drejt organeve qendrore, jo lokale. Ne nuk marrim veprime sepse nuk na takon.

**Naim Bajraktari, KLSP Bregu i Diellit, Ulpianë**, përshëndeti iniciativën për angazhimin e këtij këshilli.

Ai tha se për mua është mbledhja e parë, andaj desha të njoftohem me ju dhe ju përgëzoj për këtë iniciativë.

**Bekim Zogiani**, me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Policisë, është themeluar KLSP më e re në

Komunën e Prishtinës, Ulpiana, Bregu i Diellit.

Falënderim i veçantë për rreshteren, shefen e sektorit, e cila e ka bërë angazhim së bashku me policen Hanumshahen, ne identifikimin e qytetareve të cilët do të jenë pjese e asaj KLSP-je. Zotëri Naimi është përfaqësues fillimisht, sepse ende nuk është mbajtur takimi për zgjedhjen e kryetarëve dhe anëtarëve. **Lulzim Fushtica- IOM**, në këtë pikë sa i përket çështjes se arsimit, desha të falënderoj Komunën e Prishtinës, përkatësisht Drejtorinë e Arsimit, ne jemi duke punuar ngushtë me drejtorinë, gjatë këtij viti kemi financuar dy projekte në dy shkolla, njëra në shkollën "Nazim Gafurri" dhe tjetri në shkollën "Qemail Mustafa".

Qëllimi i projekteve ka qene shkollat qe i kemi identifikuar ne bashkëpunim me drejtorinë, që kanë pasur fëmijë që janë kthyer me familjet e tyre nga zonat e luftës, përkatësisht nga Siria dhe Iraku.

Në shkollën "Nazim Gafurri" kemi ndërtuar një klasë të veçantë, që nxënësit para se të fillojnë mësimin duhet ta kenë një mësim paraprak, ne mënyrë që të integrohen më lehtë, ndërsa në shkollën "Qemail Mustafa" jemi duke e finalizuar ndërtimin e kabinetit të TI-së.

Ai sugjeroi KLSP-në dhe qytetarët tjerë, nëse kanë projekte konstruktive dhe kreative në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit do të mundohemi të financojmë projekte të tilla të komunitetit, që për qëllim kanë ngritjen e sigurisë publike në përgjithësi. Çdo projekt i cili ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe bashkëpunimit me institucione, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë.

**Betim Abdullahu, Zyra për Komitete dhe Komunitete**, tha se ne merremi me riintegrim dhe me kthim, andaj po dëshiroj me i cekur disa pika, me e lidhur me punën që jeni duke e bërë me kabinetet me TI. Desha të theksoj se zyra jonë së bashku me Caritas-in zviceran, është në hartim e sipër të një projekti shumë të madh, i cili do të ketë në fokus trajnimin e personave të riatdhesuar dhe fëmijët e komuniteteve të klasës së 9-të deri në vitet e treta. Trajnimet do të zgjasin rreth katër muaj, në fushat e dizajnit dhe programimit, për me i përgatit për tregun e punës. Gjithashtu po e potencoj që si zyrë, së bashku me anëtarët e Komitetit për Komunitete, i kemi ndarë grupet që do të vizitojnë shkollat ku mësojnë fëmijët e komuniteteve. Kemi ndarë ekipet dhe jemi dakorduar edhe me drejtorë të shkollave që ne t'i kryejmë vizitat në ato shkolla.

**Gentiana Osmani** u shpreh se projektin e parë e kemi tek shkolla "Pavarësia", është financuar nga OSBE, mirëpo shuma me të cilën na kane financuar nuk ka mjaftuar me mbuluar deri ne fund. Kemi shkuar deri tek pjesa e zhavorrit dhe krejt çka duhet ka mbetur për me u vendosur kubzet, andaj kërkojmë përkrahjen tuaj për finalizimin e projektit.

Tjetra është se nuk ka shenjë njoftuese as tek rruga e cila qon në drejtim të shkollës, më pas është edhe pengesa që shkaktohet me vetura të banorëve tek hyrja e shkollës.

**Alban Zogaj** i luti për dërgimin e kërkesës për pjesën e kubzeve, sepse kemi hapësirë për bashkëpunim, kemi një kontratë aktive.

#### **Punëtorja e përkrahur nga IOM:**

**Diskutimi mbi qasjen për zgjidhjet e problemeve të sigurisë, të identifikuar në punëtorinë e kaluar.**

Ne punëtori u analizua situata e tashme e sigurisë në kryeqytet, duke identifikuar kërcënimet dhe duke analizuar reagimet, gjithashtu u diskutua edhe lidhur me Planin lokal të veprimtimit.

Gjatë punëtorisë u identifikuan këto rreziqe (çështje):

- **Siguria në shkolla, siguria në trafik:**
  - Internet-kafetë në afërsi të shkollave,
  - Kamerat e sigurisë,
  - Vendkalimet për fëmijë,

- Objektet e pabanuara;
- **Siguria Publike:**
  - Vetëdijesimi i shoqërisë,
  - Mirëmbajtja e nënkalimeve,
  - Ndriçimi i disa rrugëve në kryeqytet,
  - Mbeturinat - Parku i qytetit,
  - “Mati 1”, mos izolimi i objekteve në ndërtim,
  - Qentë endacakë;
- **Mirëmbajtja e ambientit:**
  - Zhurma akustike,
  - Degradimi i ambientit,
  - Deponia në Trudë.

Procesmbajtësja:  
Edona Krasniqi



Kryetari i Komunës  
Përparim Rama

